



Nr. 23/2 prot
Shkollë 14/06/18

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 19 Datë 07.03.2018

**PËR MOSMIRATIM NË PARIM TË KËRKESËS PËR PËRDORIM TË BURIMIT
UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE SUBJEKTIT "TAMARA" SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pikës 2, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni", për paisjen me autorizim (miratim në parim) të subjektit "TAMARA" sh.p.k., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

- 1- Mosmiratimin në parim të kërkesës së subjektit "TAMARA" sh.p.k., me administrator Z.Gerian KUKA, për përdorim të burimit ujor **Lumi i Cemit**, për prodhim energjie elektrike (HEC GRABOM), në Tamarë, Njësia Administrative Kelmend, Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.
- 2- Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyet e mëposhtme:

-Në Lumin e Cemit jetojnë dy specie të troftës (trofta e malit dhe trofta e Cemit) të përfshira në listën e kuqe me një status VU (i përkeqësuar). Ndërtimi i hidrocentralit do të shkatëronte dhe izolonte lëvizjen e lirë të specjeve ujore në këtë lumë.

-Shkatërron mjedisin dhe turizmin

-Vështirësonte jetën sociale dhe ekonomike të banorëve.

-Ndikim negativ në zhvillimin e lojrave të kanotazhit.

- 3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Çesk MILLJA

